

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE BORDI

#### **RREGULLORE**

# PËR INFORMIMIN E TË SIGURUARIT APO PERSONAVE TË TJERË TË INTERESUAR PËR SA U PËRKET ZHVILLLIMEVE DHE NDRYSHIMEVE LIGJORE NË SEKTORIN E SIGURIMEVE

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 36, datë 28.05.2015

## Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për informimin e të siguruarit apo personave të tjerë të interesuar për sa u përket zhvillimeve dhe ndryshimeve ligjore, sipas të cilave shoqëria e sigurimit merr masat teknike dhe administrative për krijimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.

### Neni 2 Fusha e veprimit

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe risigurimi në Republikën e Shqipërisë.

# Neni 3 Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të pikës 1, të nenit 66, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".

#### Neni 4 Përkufizime

Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) "Informacion" është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë së Sigurimit, pavarësisht nëse është përpiluar apo jo nga vetë shoqëria;
- b) "Ligji" është Ligji nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit";
- c) "Person" është çdo person fizik apo juridik i siguruar apo person tjetër i interesuar për sa u përket zhvillimeve dhe ndryshimeve ligjore në sektorin e sigurimeve;
- d) "Shoqëri" është shoqëria e sigurimit/risigurimit sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".

### Neni 5 Parimet themelore

Dispozitat e kësaj rregulloreje mbështeten në parimet themelore të mëposhtme:

### a) Parimi i transparencës

Shoqëritë e sigurimit janë shoqëri të hapura ndaj publikut (të siguruarve dhe personave të interesuar) dhe në zbatim të detyrimeve të tyre ligjore publikojnë, informojnë dhe shpjegojnë politikat, objektivat dhe procedurat e tyre.

#### b) Parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit

Shoqëritë e sigurimit nuk privilegjojnë apo diskriminojnë asnjë person që kërkon informacion prej tyre për shkak të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore gjatë zbatimit të kësaj rregulloreje.

### c) Parimi i bashkëpunimit të ngushtë dhe i besimit reciprok

Të gjitha njësitë organizative dhe personeli i shoqërive të sigurimit, bashkëpunojnë për të garantuar të drejtën e informimit ndaj publikut dhe mbrojtjen e konfidencialitetit të informacionit.

#### d) Parimi i përgjegjshmërisë

Shoqëritë e sigurimit janë institucione të përgjegjshme, të cilat nëpërmjet publikimit të informacionit tregojnë gatishmërinë e tyre për të qenë transparente me subjektet e siguruara dhe çdo person të interesuar.

#### e) Parimi i ruajtjes së konfidencialitetit

Shoqëritë e sigurimit ruajnë konfidencialitetin e çdo informacioni të klasifikuar si "jopublik", sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.

#### f) Parimi i ruajtjes të të dhënave personale

Përdorimi i të dhënave personale në shoqëritë e sigurimit bëhet duke respektuar

detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

## Neni 6 E drejta për informim

- 1. Shoqëria e sigurimit, gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, duhet të informojë çdo person në lidhje me informacionin e parashikuar në nenin 66, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".
- 2. Shoqëria e sigurimit, merr të gjitha masat teknike dhe administrative për të krijuar infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, për të përmbushur detyrimin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

# Neni 7 Krijimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit

- 1. Shoqëria e sigurimit krijon njësinë e teknologjisë së informacionit e cila mundëson ngritjen e infrastrukturës së duhur dhe të përshtatshme të teknologjisë së informacionit për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në nenin 66 të Ligjit të mësipërm.
- 2. Njësia e teknologjisë së informacionit duhet të jetë në përputhje me përmasat e shoqërisë së sigurimit, cilësinë dhe kompleksitetin e produkteve që ajo ofron dhe aktivitetin e saj.
- 3. Infrastruktura e teknologjisë së informacionit duhet që të mundësojë minimalisht:
  - a) ruajtjen e sigurt, përdorimin dhe mbajtjen rezervë të të gjithë informacionit që ka lidhje me veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit;
  - b) bashkëveprimin e të dhënave në bazë të produkteve, llojet e veprimtarisë, gjeografisë apo klasifikimit të rrezikut.
- 4. Shoqëria e sigurimit garanton ruajtjen e sigurisë së infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.
- 5. Shoqëria e sigurimit garanton vazhdimësinë e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit nëpërmjet përditësimeve të rregullta dhe mirëmbajtjes së nevojshme.

# Neni 8 Kanalet e përshtatshme të komunikimit

1. Shoqëria e sigurmit krijon kanale të përshtatshme komunikimi brenda strukturës së saj organizative në mënyrë që informacioni të jetë sa më lehtësisht i aksesueshëm dhe i raportueshëm.

2. Shoqëria e sigurimit është përgjegjëse për mundësimin e dërgimit të informacionit, brenda strukturës së saj organizative, te personat përkatës që përpunojnë, ruajnë apo shpërndajnë informacionit.

# Neni 9 Informimi i publikut

- 1. Shoqëria e sigurimit informon publikun, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të publikut, garantimin e njohjes maksimale me informacionin dhe vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve.
- 2. Informacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni duhet të jetë:
  - i plotë;
  - i saktë;
  - i përditësuar;
  - i thjeshtë në konsultim;
  - i kuptueshëm;
  - lehtësisht i aksesueshëm;
  - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të shoqërisë së sigurimit.

# Neni 10 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.